



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFISHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Nr. 5381/prot

Vau Dejës, me 03/10 /2025

Lënda : Mos zbardhje të vendimit të Këshillit Bashkiak lidhur me projekt vendimin nr.10 datë 19.09.2025.

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në zbatim të ligjit nr 22/2018 “ Për strehimin social”i ndryshuar; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore VKM-së nr.362 prot, datë 29.05.2019 “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij. Kërkojme mos zbardhje të vendimit të Këshillit Bashkiak lidhur me projekt vendimin nr.10 datë 19.09.2025 i shqyrtuar në mbledhjen e datës 29.09.2025 për banoren Znj.Dila Jaku ne programin e strehimit social subvencioni i qirasë në tregun e lire pasi kërkesja nuk ka paraqitur kontratë qiraje noteriale.

KRYETARI
Kristian Shkreli

Në mungesë dhe me urdhër

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni



Konceptoi: D.Lleshi

Miratoi: R.Luzaku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Shtator 2025

Data 29.09.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.08.2025, si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Gusht 2025.
- 3.Projekt vendim për miratimin e subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për Znj.Dila Jaku në programin e strehimit “Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë”
- 4.Projekt vendim për revokim të Vkb nr.37 datë 05.12.2013 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me nr.6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji i pasurisë ish magazinë e H/C Vau Dejës”

5.Të ndryshme.

grupe interesi nuk kishte prezent në mbledhje. Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 29.09.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 19 këshilltarë,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Neki Kapllanaj, Samed Hasmegaj, Ornela Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Kastriot Shkjau, Ermir Tahiri, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Mirela Vasija, Edona Molla, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Martin Mardoda, Roberto Trushi, Ferdinand Fusha), korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Rendi i ditës u miratua me 19 vota Pro.Këshilltarët që votuan pro: Këshilltarët që votuan pro:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Neki Kapllanaj, Samed Hasmegaj, Ornela Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Kastriot Shkjau,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ermir Tahiri, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Mirela Vasija, Edona Molla, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Martin Mardoda, Roberto Trushi, Ferdinand Fusha). Pas miratimit të rendit të ditës, Z. Ferdinand Fusha, largohet nga mbledhja, pa dhënë ndonjë arsye. Të pranishëm në sallë mbeten 18 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Z. Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.08.2025 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 29.08.2025 nga Z. Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro: :(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Neki Kapllanaj, Samed Hasmeqaj, Ornella Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Kastriot Shkjau, Ermir Tahiri, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Mirela Vasija, Edona Molla, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Martin Mardoda, Roberto Trushi).

Z. Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Gusht 2025

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se projekt vendimi është hartuar bazuar ne ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Ajo shprehet se projekt vendimi propozon qe: Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Gusht 2025 , familje 129, me 414.132 lekë, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Gusht 2025 janë shpallur fitues, 924 familje, me fond 6.918.838 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 415.130 lekë.

Z. Ervis Shimaj spjegon se komisioni i K. Bashkiak ka propozuar miratimin e projekt vendimit.



Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Neki Kapllanaj, Samed Hasmeqaj, Ornela Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Kastriot Shkja, Ermir Tahiri, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Mirela Vasija, Edona Molla, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Martin Mardoda, Roberto Trushi).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për Znj.Dila Jaku në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë"

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Edmond Gjeçaj- specialist pranë zyres së strehimit social, Bashkia Vau Dejës, i cili spjegoi se për hartimin e projekt vendimit është zbatuar me korrektesë baza ligjore dhe se komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr.21 me 26.03.2025 "Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit", realizoi mbledhjen në datën 12.06.2025, ku u bë shqyrtimi i dokumentacionit të plotë dhe deklarates noteriale për banorën Dila Jaku.

Nga vlersimi social ekonomik vërehet se kjo banorë trajtohet me KEMP nga gjendja shendetesore jo mire, jeton me qira me të ardhura të pamjaftueshme nga pagesa e KEMP-it për të perballuar qiranë dhe shpenzimet e tjera jetike. Komisioni i strehimit e shikoj të arsyeshme për të asistuar si përfituese të programit të strehimit subvencioni i qirasë në tregun e lirë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Frano Prenga pyet: Sipas ligjit kontrata noteriale duhet të bëhet përpara se këshilli të marrë vendim apo pas? Sepse bashkëngjitur projekt vendimit nuk keni sjellë kontartë qiraje por keni paraqitur vetë deklaratë noteriale.

Z.Edmond Gjeçaj përgjigjet:Kontrata noteriale bëhet përpara se këshilli të marrë vendim, por në rastin konkret zonja ka paraqitur deklaratë noteriale.

Z.Frano Prenga deklaroi se projekt vendimet duhet të sillni të plotësuar me dokumentat që kerkohen nga ligji por unë do e jap këtë radhë votën pro.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët e tjerë nëse kanë pyetje apo diskutime lidhur me projekt vendimin.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin diçka tjetër.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin duke lënë detyrë sek.strehimit social, pajisjen me kontartë noteriale të dosjes:

Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Neki Kapllanaj, Samed Hasmeqaj, Ornela



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Kastriot Shkja, Ermir Tahiri, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Mirela Vasija, Edona Molla, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Martin Mardoda, Roberto Trushi).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për revokim të Vkb nr.37 datë 05.12.2013 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me nr.6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji i pasurisë ish magazinë e H/C Vau Dejës”

Për këtë pikë të rendit të ditës, nuk kishte përfaqësues nga zyra juridike për të relatuar për shkak të angazhimeve të tjera të parashikuara më parë nga ana e tyre, por sqarimet për projekt vendimin i dha Z.Ervis Shimaj- kryetar i këshillit bashkiak i cili spjegoi se për këtë projekt vendim është mbledhur komisioni i K.B dhe ka shqyrtuar projekt vendimin dhe ka propozuar miratimin e tij në mbledhjen e këtij muaji.

Drejtorja e planifikimit të territorit, kadastrës dhe investimeve publike pranë Bashkisë Vau Dejës, nëpërmjet projekt vendimit të paraqitur kërkon revokim të Vkb nr.37 datë 05.12.2013 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me nr.6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji i pasurisë ish magazinë e H/C Vau Dejës”

Kërkohej anulimi i çdo procedure të mundshme për vijimin e privatizimit të këtyre magazinave për arsyen se bie ndesh me vizionin e Bashkisë Vau Dejës për rivitalizimin e këtyre territoreve.

Vendndodhja e këtyre magazinave është një pikë strategjike për qytetin dhe për qytetarët e tij, dhe për rrjedhojë bashkia nuk mundet të shprehet pozitiv për privatizim sepse këto hapsira do t'ju kthehen qytetarëve në shërbime rekreacioni dhe pushimi.

Z.Shimaj vazhdon të spjegojë se projekt vendimi ka të bëjë me saktësime ligjore dhe proceduriale sepse këshilli bashkiak në vitin 2024, ka vendosur që qendra e qytetit të Laçit të rivitalizohet nëpërmjet projektit të paraqitur në atë vendim.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohej me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Neki Kapllanaj, Samed Hasmeqaj, Orneta Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Kastriot Shkja, Ermir Tahiri, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Mirela Vasija, Edona Molla, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Martin Mardoda, Roberto Trushi).

Pika e pestë:Të ndryshme: Këshilltarët nuk kishin pyetje apo probleme për të ngritur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari Këshillit pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera e deklaroi të mbyllur mbledhjen e datës 29.09.2025.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA

Këshilltarët:

1. Ervis Shimag
2. Frau Prenja
3. Neli Vepllanaj
4. Samir Hasani
5. Ornela Heshi
6. Majlinda Ndrej
7. Leonora Prenja
8. Kastriot Shkja
9. Ermir Tahir
10. Bregjine Shkëlqej
11. Violeta Markolaj
12. Mirëza Vasija
13. Edona Molla
14. Vollë Zogaj
15. Mark Bech

16. Donje Vajti
17. Martin Markolaj
18. Roberto Mishi
19. Revdinand Fusha
20. _____
21. _____
22. _____
23. _____
24. _____
25. _____
26. _____
27. _____
28. _____
29. _____
30. _____
31. _____